



Pranimi / Dorezimi Prilazja / Prilazja Received / Delivered	03.02.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	506/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1015/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi- kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti- anëtar, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1015/2021 të datës 07.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1015/2021 e datës 07.12.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet Njoftimi i Komunës së Prishtinës për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00007776 të datës 22.10.2021, ngritje në detyrë, për pozitën e punës Udhëheqës i Auditimit, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën një të dispozitivit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 07.12.2021 ka parashtruar ankesë në formë postare, më numër protokollit 5846/21, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (tutje referuar Këshilli), kundër Njoftimit të Komunës së Prishtinës të datë 19.11.2021, të shpallur në Sistemin për

menaxhimin e Burimeve Njerëzore (tutje referuar SMBNJ) për konkursin ngritje në detyrë, për pozitën e punës Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, për shkak të aplikimit të gabuara të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Shërbimin Civil, mos aplikimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe shkelje të dispozitave të Kodit Penal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 10.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit për kundër kërkesave të vazhdueshme me shkrim nga Këshilli, nuk ka ofruar përgjigje në ankesë dhe e njëjta nuk ka ofruar prova lidhur me çështjen në procedurë.

Me datë 20.01.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me nr.protokolli 266/2022, me të cilin është vazhduar afati i ankesës me numër A.nr.1015/2021 të datë 07.12.2022, për dhjetë ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot: 5846/2021 të datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesi përmes postës së Kosovës me numër R 1970917 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Pliko me numër R 1970917 të datës 03.12.2021; E-mail nga _____ për datës 02.12.2021; E-mail nga _____ për _____ i datës 23.11.2021; E-mail nga _____ për _____ i datës 19.11.2021; Ankesë e datës 23.11.2021 për _____ Dëshmi/printscreen e shpalljes së konkursit për lëvizje (paralele) brenda kategorisë; Konkurs me numër reference RN00006808 i datës 22.10.2021; CV-ja e ankuesit me rastin e aplikimit përmes SIMBNJ-së e datës 25.10.2021; Dëshmi/printscreen e shpalljes së Konkursit lëvizje paralele dhe avancimit; Konkursi për ngritje (Avancim) në detyrë i datës 06.11.2021; E-mail nga ankuesi ne adresën elektronike të SIMBNJ-së, Njoftim i datës 19.11.2021 nga sektori i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës lidhur me Konkursin Avancim ne detyrë me nr. ref.RN00007776, Emajl konfirmi nga SIMBNJ i datës 25.10.2021 lidhur me procesin e aplikimit të ankuesit, Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 5970 e datës 10.12.2021, email- kërkesë e datës 11.01.2022 nga Këshilli, Kërkesë për përgjigje e datë 25.01.2022, Përgjigje në kërkesë nga Personeli i Komunës e datës 01.02.2022(E-mail); Provat e nxjerra nga SIBMNJ lidhur me procedurën e rekrutimit, për pozitën "Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm", për lëvizjen (paralele) brenda kategorisë dhe procedurën e avancimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit _____, është e bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të ofruara nga ankuesi dhe të siguruara nga Kolegji përmes SMBNJ-së, është konstatuar se Komuna e Prishtinës me datë 19.07.2021, ka shpallur Konkursin me Nr.reference RN00006808, lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 22.10.2021 deri me 29.10.2021, e në të cilin konkurs me datë 25.10.201, ka aplikuar edhe ankuesi me c 'rast ka pranuar edhe emalin kon firmues nga SIMBNJ se procesi i aplikimit ishte kryer me sukses.



Komuna e Prishtinës me datë 22.10.2021, për pozitën e njëjtë të punës shpall Konkursin me nr. reference RN00007776, ngritje (Avancim) në detyrë, i hapur për aplikim nga data 06.11.2021 deri me 13.11.2021.

Ankuesi duke mos qenë i njoftuar me ecurinë e procedurës së konkurrimit me Nr.reference RN00006808 lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm, me datë 19.11.2021 i është drejtuar me kërkesë më shkrim Njesisë së Personeli të Komunës së Prishtinës përkitazi me bazën ligjore lidhur me shpalljen e Konkursit për avancim të datës 22.10.2021 si dhe për qasje në dokumenteve të dorëzuar nga aplikantet.

Ankuesi me datës 23.11.2021 parashtron ankesë kundër Njoftimit të Konkursit me nr. reference RN00007776 Ngritje (Avancim) në detyrë, e për vendosjen e së cilës nuk ka dëshmi se e njëjta është shqyrtuar nga Njësia e Personelit të Komunës së Prishtinës.

Ankuesi me datë 07.12.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil kundër Njoftimit të Konkursit me nr. reference RN00007776 Ngritje (Avancim) në detyrë, për shkak të aplikimit të gabuara të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Shërbimin Civil, mos aplikimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe shkelje të dispozitave të Kodit Penal. Me tej shton se nuk ka pranuar asnjë njoftim lidhur me aplikimin e tij në Konkursin me nr.reference Rn00006808 lëvizje brenda kategorisë, i është mohuar e drejta e ankesës dhe se Komuna e Prishtinës në kundërshtim me ligjin po në të njëjtën ditë kur ka qenë i hapur Konkursi për lëvizje brenda kategorisë, po në të njëjtën ditë Komuna e Prishtinës ka bërë shpalljen e Konkursit për avancim për pozitën e njëjtë të punës. Kërkon që Këshilli ta prish Njoftimin e Konkursit me nr. reference RN00007776 Ngritje (Avancim) për pozitën e punës Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm dhe të përsëritet procedura e rekrutimit në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në dispozitat e nenit 43 dhe 54 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 38 paragrafi 4 dhe nenin 39 paragrafi 3 Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, sjell në vëmendje se konkurrimi për lëvizje brenda kategorisë dhe konkurrimi ngritjen në detyrë organizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit që ka pozitën e lirë.

Përkitazi me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i 'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë respektivisht nenit 38 ku është përcaktuar se: *1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji...*" dhe nenit 39 po te të njëjtit ligj ku parashihet se: *Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë.. dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji vlerëson së organi i punësimit respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së*

Prishtinës, në rastin konkret lidhur me plotësimin e pozitës së lirë të Udhëheqësit të Auditimit të Brendshmen si pozitë e ulët drejtuese, fillimisht duhej të zbatonte procedurën e konkurrimit lëvizje brenda kategorisë dhe vetëm nëse pozita në fjalë nuk mund të plotësohej përmes lëvizjes brenda kategorisë atëherë mund të vazhdohej me procedurën e konkurrimit të ngritjes (avancimit) në detyrë. Kështu që bazuar në këtë konstatim dhe duke marr parasysh faktin se organi i punësimit nuk ka ofruar asnjë dëshmie lidhur me arsyet e hapjes së procedurës së konkurrimit të ngritjes në detyrë për pozitën e Udhëheqësit të Auditimit të Brendshmen pa zhvilluar procedurën për lëvizje brenda kategorisë dhe po ashtu nisur nga rrethana se ankuesi nuk është informuar në ndonjë formë lidhur me aplikimin e tij dhe arsyet e mos vazhdimin të Konkursit të shpallur me datë 19.07.2021 për lëvizje brenda kategorisë, Kolegji vlerëson se veprimet e tilla janë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore si me lartë dhe me parimet themelore të procedurës administrative lidhur me ligshmërinë, transparencën dhe ushtrimin e mjeteve juridike ashtu siç është e përcaktuar me nenin 4, 9 dhe 13 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke bazuar në nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të aprovohet si e bazuar ankesa e ankuesit dhe të anulohet Njoftimi për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00007776 të datës 22.10.2021, ngritje në detyrë, për pozitën e punës Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm në Komunën e Prishtinës, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.Nr.1015/2021.

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së